

**UDHËZIM**  
**Nr. 21, datë 14.7.2025**

**PËR KONTROLLIN E BRENDSHËM DHE VERIFIKIMIN E MASAVE PËR  
ZBATIMIN E INSTRUMENTIT TË FACILITETIT PËR REFORMA DHE RITJE**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9 të ligjit nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 2.5.2025, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësiave e të marrëdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin, sipas parashikimeve të marrëveshjes së facilitetit, ratifikuar me ligjin nr. 19/2025”, ministri i Financave

**UDHËZON:**

**I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë procedurat, funksionet dhe rolet për të gjitha institucionet e përfshira në zbatimin dhe monitorimin e Instrumentit të Facilitetit për Reforma dhe Rritje (Instrumenti RGF), në përputhje me Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027 të miratuar me vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, si dhe me ligjin nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”.

2. Udhëzimi përcakton kornizën për zbatimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm për të garantuar integritetin, transparencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve në kuadër të këtij Instrumenti. Ai mbështet përgatitjen e Deklaratës së Sigurisë, pjesë e kërkesës për pagesë, sipas kushteve të marrëveshjes së facilitetit dhe siguron zbatimin në praktikë të parimeve të menaxhimit të mirë financiar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik.

3. Objektivat specifikë të këtij udhëzimi janë:

a) Të përshkruajë proceset dhe hapat për zbatimin e kontrollit të brendshëm dhe auditimit, duke përfshirë verifikimin e përmbushjes së objektivave dhe treguesve sasiorë e cilësorë, si dhe të përputhshmërisë me parimet horizontale të menaxhimit financiar publik;

b) Të përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Kombëtar, ministrisë përgjegjëse për Financat dhe institucioneve të tjera zbatuese, në zbatim të Instrumentit dhe raportimin e tij sipas standardeve të përcaktuara nga BE dhe ligji shqiptar.

**II. PARIME DHE KUADRI LIGJOR**

1. Zbatimi i këtij udhëzimi bazohet në parimet e kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik që përfshijnë:

a) Menaxhim i mirë financiar, efikasitet dhe efektivitet në përdorimin e fondeve publike;

b) Transparencë dhe llogaridhënie institucionale përmes strukturave të raportimit dhe auditimeve të rregullta;

c) Parandalim dhe zbulim i mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesit dhe shkeljeve të tjera;

d) Sigurimi i pakthyeshmërisë së reformave dhe shmangia e financimit të dyfishtë;

e) Pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Brendshëm dhe Auditimit, në përputhje me Kornizën e Kontrollit të Brendshëm të Komitetit COSO dhe Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm.

2. Zbatimi i kontrollit të brendshëm dhe auditimit, në kuadër të këtij Instrumenti mbështetet në aktet ligjore dhe rregullatore të mëposhtme:

a) Rregullore (BE) 2024/1449 e Bashkimit Evropian, që përcakton kornizën e përgjithshme për zbatimin e facilitetit për reforma dhe rritje;

b) Ligji nr. 18/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE-së për mbështetje buxhetore”;

c) Ligji nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”;

d) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 2.5.2025, “Për strukturën dhe mekanizmat institucionalë për zbatimin e marrëveshjes së facilitetit për reforma dhe rritje”;

e) Ligji nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, që rregullon organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në institucionet shtetërore;

f) Ligji nr. 10 296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

### III. STRUKTURAT PËRGJEGJËSE DHE ROLET E TYRE

#### 1. Koordinatori Kombëtar (KK)

1.1. Koordinatori Kombëtar ka për detyrë koordinimin e përgjithshëm të Instrumentit të RGF-së me Komisionin Evropian përfshirë procesin e zbatimit të reformave dhe investimeve në kuadër të Instrumentit të RGF-së. Përgatit së bashku me ministrinë përgjegjëse për financat dhe nënshkruan deklaratën e sigurisë.

#### 2. Zyra Mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar (ZMKK)

2.1 ZMKK-ja mbështet Koordinatorin Kombëtar në koordinim dhe monitorim të Instrumentit të RGF. Përgatit raportet gjashtëmujore dhe vjetore, formulon kërkesat për pagesa dhe ofron këshillim teknik për ministritë e linjës, duke konsoliduar raportet përfundimtare.

#### 3. Ministria përgjegjëse për financat

3.1 Ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe raportimin financiar, ushtron rolin e saj si autoritet koordinues për harmonizimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK), si dhe të funksionit të auditimit të brendshëm në institucionet e sektorit publik, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 10 296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si dhe me nenin 9 të marrëveshjes së facilitetit.

3.2. Në këtë funksion, ministria përgjegjëse për financat:

a) Koordinon dhe monitoron funksionimin e Sistemit të Menaxhimit të Parregullsisë, si dhe zbatimin e masave parandaluese dhe korrigjuese ndaj mashtrimit dhe parregullsisë;

b) Forcon dhe ndjek nga afër procedurat e kontrollit të brendshëm dhe mekanizmat e raportimit, në lidhje me zbatimin e Instrumentit të RGF për reforma dhe rritje;

c) Harton dhe shpërndan udhëzime standarde (p.sh., lista kontrolli) për verifikimin dhe dokumentimin e hapave të reformave nga institucionet zbatuese;

d) Koordinon funksionin e auditimit të brendshëm në institucionet përfituese dhe përgatit përmbledhjen e konsoliduar të auditimeve të kryera në kuadër të përgatitjes së deklaratës së sigurisë;

e) Përgatit dhe zbaton protokolle bashkëpunimi me institucionet e BE-së, përfshirë Komisionin Evropian, OLAF-in dhe EPPO-në, për çështje që lidhen me mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së;

f) Mbledh dhe vlerëson provat verifikuese dhe dokumentacionin mbështetës nga institucionet zbatuese, dhe dorëzon dy herë në vit raportin përgatitor për deklaratën e sigurisë, që i bashkëlidhet kërkesës për disbursimin e fondeve.

#### 4. Ministritë e linjës dhe institucionet zbatues/beneficiare

4.1. Ministritë e linjës dhe institucionet zbatuese janë përgjegjëse për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e reformave dhe investimeve të mbështetura nga Instrumenti RGF.

4.2. Detyrimet e ministrive dhe të institucioneve zbatuese përfshijnë:

a) Zbatimin e udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për financat, në lidhje me proceset në kuadër të nënshkrimit të deklaratës së sigurisë;

b) Hartimin e planeve tremujore të zbatimit, të përditësuara në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me objektivat dhe treguesit e Marrëveshjes së Facilitetit;

c) Sigurimin dhe ruajtjen e evidencave dhe provave të verifikueshme, që dokumentojnë zbatimin real të hapave të reformave;

d) Funksionimin efektiv të auditimit të brendshëm, duke kryer auditime të rregullta mbi sistemet e kontrollit të brendshëm në zbatim të Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm dhe kuadrit ligjor kombëtar; si dhe raportimin përkatës pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm;

e) Përgatitjen e raporteve periodike gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe çdo raport tjetër të kërkuar në kuadër të monitorimit të Instrumentit.

#### IV. PROCESI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

1. Kontrolli i brendshëm në kuadër të zbatimit të Instrumentit për Reforma dhe Rritje (RGF) është një proces i vazhdueshëm dhe sistematik, që synon të sigurojë përdorimin e ligjshëm, të rregullt, ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve të Bashkimit Evropian, si dhe arritjen e objektivave të reformës të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027.

2. Vendosja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bazohet në **sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit**, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor për menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe me **nenin 9 të Marrëveshjes së Facilitetit**, i cili kërkon që autoritetet kombëtare të garantojnë vendosjen e sistemeve të përshtatshme të kontrollit të brendshëm dhe auditimit.

3. Çdo institucion përfitues duhet të sigurojë:

a) Sisteme efektive kontrolli për parandalimin, zbulimin dhe adresimin e financimit të dyfishtë (parimet e kontrollit të brendshëm të njohura ndërkombëtarisht);

b) Sistem transparence për të dokumentuar burimet e financimit për çdo hap/aktivitet;

c) Deklaratë sigurie që vërteton se kontrollet janë zbatuar dhe gjithë burimet janë raportuar;

d) Vetëdeklarimi mbi përmbushjen e detyrimeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm kryhet nga Sekretari i Përgjithshëm në rastet e ministrive dhe nga titullari i institucionit në rastet e ministrave të shtetit, agjencive të varësisë dhe institucioneve të pavarura dhe i dërgohet ministrisë përgjegjëse për financat.

4. Institucionet zbatuese kanë detyrimin të identifikojnë riskun për çdo hap reforme apo investimi që zbatojnë. Ato duhet të hartojnë plane të kontrollit të brendshëm ku përshkruhen qartë aktivitetet e kontrollit, përgjegjësitë, afatet dhe metodat e monitorimit, të cilat duhet të përmbajnë:

a) Zonat me risk të lartë për mospërputhje apo parregullsi;

b) Masat parandaluese dhe korrigjuese për secilin risk të identifikuar;

c) Përgjegjësitë për zbatimin e kontrolleve dhe afatet përkatëse;

d) Metodologjitë e monitorimit dhe vlerësimit të masave.

5. Qasja e bazuar në risk ndihmon në përqendrimin e burimeve në fushat më kritike dhe siguron një nivel të arsyeshëm sigurie për zbatimin korrekt të Instrumentit.

6. Zbatimi i kontrolleve të brendshme përfshin verifikime administrative dhe financiare, të cilat mund të jenë analiza të dokumenteve ose kontrolle në terren. Këto veprime bëhen për të vërtetuar se masat janë zbatuar siç janë planifikuar dhe se fondet janë përdorur në mënyrë të ligjshme e të përshtatshme. Çdo rezultat i kontrollit duhet të dokumentohet në formate të standardizuara dhe të miratuara për:

a) Kontrollin mbi ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe efektivitetin e shpenzimeve;

b) Vlerësimin e përputhshmërisë së reformave me hapat dhe treguesit e miratuar.

7 Të gjitha kontrollet duhet të dokumentohen përmes formateve standarde, të miratuara nga ministria përgjegjëse për financat.

8. Për më tepër, institucionet janë të detyruara të zbatojnë masa konkrete për parandalimin e konfliktit të interesit, përmes:

a) Deklaratave të interesit nga stafi përgjegjës për procesin;

b) Sistemeve të raportimit të veçantë për konfliktet e mundshme.

9. Për të garantuar integritetin dhe transparencën në zbatimin e reformave, institucionet zbatuese duhet të vendosin mekanizma funksionalë për parandalimin e mashtrimit, korrupsionit dhe parregullsive, duke përfshirë:

- a) Protokolle të brendshme për sinjalizimin e shkeljeve (*whistleblowing*);
- b) Mbrojtjen e sinjalizuesve në përputhje me standardet e BE-së dhe legjislacionin kombëtar në fuqi;
- c) Trajnime të rregullta për stafin mbi etiken, integritetin dhe detyrimet ligjore që lidhen me administrimin e fondeve publike dhe të BE-së.

10. Institucionet janë të detyruara të ruajnë një kulturë të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë gjithë stafin në identifikimin, parandalimin dhe raportimin e çdo devijimi nga rregullat dhe objektivat e Instrumentit RGF.

#### V. PROCESI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

1. Auditimi i brendshëm përbën një shtyllë themelore të sistemit të kontrollit të brendshëm publik dhe luan një rol të pavarur, objektiv dhe këshillues në vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucionet përfituese të Instrumentit për reforma dhe rritje (RGF). Ai ndihmon në identifikimin e dobësive sistematike, përmirësimin e efikasitetit të proceseve dhe garantimin e përdorimit të rregullt dhe ligjor të fondeve të BE-së.

2. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat siguron koordinimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm për zbatimin e masave në ministritë, institucionet dhe njësitë e tjera publike përfituese.

3. Çdo institucion zbatues duhet të sigurojë shërbimin e auditimit të brendshëm sipas një prej formave të parashikuara në nenin 10 të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar dhe në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm raporton te kjo e fundit, rezultatet e auditimit në mënyrë periodike.

4. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat përgatit udhëzime specifike për auditimin, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, akteve të tjera nënligjore dhe Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm, të pranuar. Këto udhëzime përfshijnë të gjithë hapat, procedurat dhe dokumentacion që duhet të ndiqen për angazhimet e auditimit, raportimin e rezultateve të auditimit sipas afateve deri në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

5. Institucionet zbatuese përgatisin raporte gjashtëmujore të auditimeve, të cilat dorëzohen deri më 15 qershor dhe 15 dhjetor të çdo viti te struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm. Kjo strukturë konsolidon raportet e auditimeve dhe përgatit përmbledhjen me rezultatet e auditimeve si pjesë e raporteve periodike dhe mbështetje të kërkesave për pagesë për periudhën takuese. Ministria përgjegjëse për financat dërgon pranë Koordinatorit Kombëtar gjithë dokumentacionin për nënshkrimin e deklaratës së sigurisë brenda datës 5 korrik dhe 5 janar të çdo viti.

6. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen ministritë e linjës dhe institucionet raportuese, duke përfshirë strukturat përgjegjëse për menaxhimin financiar, kontrollin dhe njësitë e auditimit të brendshëm në këto institucione, ministria përgjegjëse për financat, duke përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik dhe Raportimit Financiar si dhe Koordinatori Kombëtar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE  
**Petrit Malaj**